



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63, nenit 12 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në zbatim të nenit 8, germa b) të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 10 Qershor 2020 merr këtë:

V E N D I M

për çregjistrim të partisë politike Lëvizja për Drejtësi-LD



- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për çregjistrimin dhe largimin nga regjistri i partive politike të partisë politike "Lëvizja për Drejtësi -LD", për mosdorëzimin e Formularit për vazhdimin e regjistrimit në pajtim me nenin 7 të Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- II. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike "Lëvizja për Drejtësi -LD", për marrjen e këtij Vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Partia politike, "Lëvizja për Drejtësi" me akronimin LD e regjistruar më 23 Mars 2013, nuk ka përbushur obligimet që dalin nga neni 7 i Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, respektivisht nuk e ka dorëzuar Formularin për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike që duhet të dorëzohet deri më 31 Mars të çdo viti kalendarik si dhe pas afatit shtesë të dhënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri më 5 Qershor 2020.



Këshillë juridike: Partia Politike, "Lëvizja për Drejtësi" me akronimin LD, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pezullim nga regjistri i partive .